

VENDIM
Nr. 192, datë 5.4.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 822, DATË 7.10.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË NDËRTIMIT TË KAPACITETEVE TË REJA PRODHUESE TË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË NUK JANË OBJEKT KONCESIONI”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 822, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas shkronjës “gj”, të nenit 7, shtohet shkronja “h”, me këtë përmbajtje:

“h) dokumentacionin ligjor, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, që provon marrëdhënien afatgjatë mbi pasurinë që do të përdoret për ndërtimin e burimit gjenerues. Kërkesa refuzohet në rastet kur pasuria ku propozohet ndërtimi ka kufizime shfrytëzimi, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe zonave të mbrojtura.”.

2. Në fund të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 10, bëhet shtesa, si me këtë përmbajtje:

“Opinionin paraprak i OST-së ose OSSH-së në këtë fazë të procesit shërben vetëm për të përcaktuar mundësinë e lidhjes në rrjet. Ky opinion nuk angazhon OST-në ose OSSH-në për rezervimin e kapaciteteve të rrjetit, deri në pajisjen e subjekteve me miratim paraprak nga ministri sipas këtij vendimi.”.

3. Shkronja “c”, e pikës 3, të nenit 19, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) afatin maksimal 6-mujor (gjashtëmujor), brenda të cilit kërkuesi duhet të përfundojë matjet ose studimet e tjera lidhur me investimin, sipas shkronjës “b”, të kësaj pike, si dhe dokumentacionin e përcaktuar në nenin 20, të këtij vendimi.”.

4. Shkronja “dh”, e nenit 20, shfuqizohet.

5. Kudo në përmbajtje të këtij vendimi, termi “OSHEE” zëvendësohet me termin “OSSH”.

II. Të gjitha subjektet, që nuk janë pajisur me miratim paraprak deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, janë të detyruara të plotësojnë kërkesat e këtij vendimi.

III. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama